

Banka të siguruara



ProCredit Bank



Emporiki Bank



Veneto Banca



Credins Bank



Banka Kombëtare Tregtare



Alpha Bank



Intesa Sanpaolo Bank



Union Bank



Raiffeisen Bank



Banka Ndërkombëtare Tregtare



Banka e Bashkuar e Shqipërisë



Banka e Kreditit të Shqipërisë



NBG Bank



First Investment Bank



SOCIETE GENERALE GROUP



Albanian Deposit Insurance Agency

Agjencia e Sigurimit të Depozitave



DEPOZITUES!

Paratë tuaja janë të sigurta në Bankë

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
i bën ato edhe më të sigurta



Albanian Deposit Insurance Agency

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit (pallati pranë Ambasadës
Amerikane), Nr.317, Tiranë, Tel.: +355 4 2347298
www.dia.org.al

I dashur depozitues!

A e dini se ?

JU nuk keni nevojë të aplikoni për sigurimin e depozitave tuaja!

Për sa kohë që JU depozitoni paratë tuaja pranë çdo banke që operon në Shqipëri, çdo depozitë e pranueshme sipas ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave” dhe ndryshimeve të tij, është automatikisht e mbrojtur, pa asnjë shpenzim për Ju, deri në shumën 2.500.000 lekë për çdo depozitues në secilën bankë.

A e dini se?

ASD, si pjesë përbërëse e rrjetit të sigurisë financiare në vend, vepron si një përforcues i sigurisë suaj financiare, ndërsa nxit stabilitetin dhe forcimin e sistemit bankar e financiar në Shqipëri.

Këshilla praktike

Mbani mend:

Të dhënat minimale që JU depozitues - individ duhet të regjistroni në Bankën tuaj për të mundësuar identifikimin tuaj korrekt dhe të saktë në rast nevojë, janë minimalisht 6 (gjashtë):

1. Emri
2. Mbiemër
3. Atësia
4. Dokumenti i identifikimit
5. Adresa
6. Numri i telefonit

- Depozitoni një kopje të dokumentit të identifikimit në Bankën Tuaj
- Mbani me vete dhe identifikohuni në sportelin e bankës me të njëjtin dokument identifikimi
- Njoftoni menjëherë bankën për çdo ndryshim të të dhënave të mësipërme
- Depozitoni nënshkrimin apo firmën dhe nënshkruesi/firmosni çdo dokument bankar që tregon apo autorizon lëvizjet nga llogaria/depozita juaj
- Çdo neglizhencë lidhur me veprimet e mësipërme do të vështirësojë e vonojë procesin e identifikimit tuaj dhe të veprimeve tuaja bankare në rast nevojë.

Të drejtat dhe detyrimet që JU depozitues keni në bankë lidhur me kontrollin e gjendjes së llogarisë/depozitës Suaj

- Kontrolloni dhe informohuni rregullisht mbi lëvizjet dhe gjendjen e llogarisë tuaj depozitë.
- Informohuni vazhdimisht mbi ndryshimin e interesit të shpallur në bankën tuaj.
- Njoftoni autoritetet përkatëse (BSH dhe ASD) për çdo parregullsi që vëren në drejtim të mbajtjes së të dhënave tuaja individuale, të procesit të identifikimit tuaj, të informacionit mbi gjendjen e llogarisë/depozitës suaj etj.

Në rast të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në bankën e siguruar:

- Agjencia verifikon dhe paguan depozituesin sipas të dhënave të regjistruara në bankë.
- Agjencia e Sigurimit të Depozitave në çdo rast njofton depozituesit për vendin, kohën dhe mënyrën e pagesës sipas ligjit “Për Sigurimin e Depozitave” dhe ndryshimeve të tij, nëpërmjet mjeteve të komunikimit (medias së shkruar dhe vizive), si dhe publikon çdo informacion që lidhet me të në faqen e internetit.
- JU si depozitues, duhet të paraqisni dokumentin e identifikimit të regjistruar në bankë dhe dokumentin që vërteton të drejtat tuaja ndaj bankës, për të përfituar në kohë pagesën siç përcaktohet në ligjin “Për Sigurimin e Depozitave” dhe ndryshimeve të tij.

Për informacione apo pyetje të ndryshme lidhur me sigurimin e depozitave JU duhet të drejtoheni:

Në bankën Tuaj, e cila sipas ligjit “Për Sigurimin e Depozitave” dhe ndryshimeve të tij, duhet të informojë klientët e saj lidhur me sigurimin e depozitave, e veçanërisht për llojin e depozitave që sigurohen.

Në ambjentet e ASD, ku mund të gjeni çdo informacion tjetër për sigurimin e depozitave.

